



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 752, Datë 03.12.2020

**“Për një shtesë në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2020  
“Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e  
importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe  
tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe  
tregtimit me shumicë të termometrave””**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Eduard YPI	Anëtar
Z. Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 03.12.2020, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Për një shtesë në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2019 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave”.

**Baza Ligjore:** Neni 4, neni 24, shkronja (d), neni 26, neni 43, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji nr. 9121/2003).

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

**VËREN SE :**

1. Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 716, datë 15.10.2020 për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjeve “CFO Pharma” SHPK, “Rejsi Farma” SHPK, “Delta Pharma – AL” SHPK, “Pharma One” SHPK, “Intermed” SHPK, “Alfarmakos” SHPK, “Trimed” SHPK, “Megapharma” SHPK, “Evita” SHPK, “Aldosch – Farma” SHPK, “IMI – Farma” SHPK, “Fufarma” SHA, “Medicamenta” SHPK, “Mini Invest Albania” SHPK, “Delta Med” SHPK, “R&S Farma” SHPK, “O.E.S Distrimed” SHPK, “Montal” SHPK, “MSE” SHPK, “Farma Net Albania” SHPK, “Tresi – Farm” SHPK, “Incomed” SHPK, “Florifarma” SHPK, “Lekli” SHPK, “Dial – ALB” SHPK, “Sirol 2008” SHPK, “Aquila Group” SHPK, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e

importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave, vendosi:

- I. Hapjen e Procedurës së Hetimit të Thelluar ndaj ndërmarrjeve ndërmarrjeve “CFO Pharma” SHPK, “Rejsi Farma” SHPK, “Delta Pharma – AL” SHPK, “Pharma One” SHPK, “Intermed” SHPK, “Alfarmakos” SHPK, “Trimed” SHPK, “Megapharma” SHPK, “Evita” SHPK, “Aldosch – Farma” SHPK, “IMI – Farma” SHPK, “Fufarma” SHA, “Medicamenta” SHPK, “Mini Invest Albania” SHPK, “Delta Med” SHPK, “R&S Farma” SHPK, “O.E.S Distrimed” SHPK, “Montal” SHPK, “MSE” SHPK, “Farma Net Albania” SHPK, “Tresi – Farm” SHPK, “Incomed” SHPK, “Florifarma” SHPK, “Lekli” SHPK, “Dial – ALB” SHPK, “Sirol 2008” SHPK, “Aquila Group” SHPK:
    - i. në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave;
    - ii. në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues;
    - iii. në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.
  - II. Hetimi i Thelluar do të përfshijë periudhën kohore nga 01.11.2019 deri në 31.09.2020.
  - III. Raporti i hetimit të thelluar duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 6 muaj nga hapja e hetimit të thelluar
2. Në zbatim të urdhrit nr. 409, datë 16.11.2020 dhe nr. 409/1, datë 18.11.2020 “Për monitorimin në tregun e tregtimit me shumicë të produkteve maska, alkool, gel-dezinfektant dhe termometra“, u realizuan monitorime pranë ndërmarrjeve “Capital Group” SHPK, “Euromed” SHPK, “Biometric” SHPK, “Florfarma” SHPK, “Aquarius Medical” SHPK, “New Medical Plus” SHPK, “Fedos” SHPK, “Winpharma” SHPK, “Çene” SHPK, “Imipharma Albania” SHPK dhe “Lifemed” SHPK.
3. Për sa më sipër, me qëllim realizimin e një analize të plotë të ndërmarrjeve të cilat sipas monitorimit janë konstatuar se ushtrojnë aktivitet në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave, vlerësohet se është e nevojshme hapja e procedurës së hetimit të thelluar edhe ndaj ndërmarrjeve “Capital Group” SHPK, “Florfarma” SHPK, “Euromed” SHPK, “Aquarius Medical” SHPK, “New Medical Plus” SHPK, “Fedos” SHPK dhe “Winpharma” SHPK.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 43 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

#### **VENDOSI:**

- I. Në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716 datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave”, në pikën “1”, shtohen ndërmarrjet si vijon:

*“Capital Group” SHPK, “Florfarma” SHPK, “Euromed” SHPK, “Aquarius Medical” SHPK, “New Medical Plus” SHPK, “Fedos” SHPK dhe “Winpharma” SHPK.*

- II. Hetimi i Thelluar do të përfshijë periudhën kohore nga 01.11.2019 deri në 31.12.2020.
- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURENCËS**